

URDHËR
Nr.3847, datë 8.5.2009

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË
SHËRBIMIT TË PËRMBARIMIT GJYQËSOR

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Shqipërisë, të pikës 2 të nenit 7 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.8730, datë 18.1.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor”, të neneve 27, 29, 30, 31, 32 dhe nenit të 124 të Kodit të Procedurave Administrative, dhe propozimit nr.591, datë 27.4.2009 të Drejtorit të Përgjithshëm të Përmbarimit,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës për emërimin, largimin dhe shkarkimin e personelit tekniko-administrativ të Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor në nivel qendror dhe vendor, Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor.

2. Çdo urdhër i mëparshëm, i nxjerrë me të njëjtin objekt, revokohet.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe një kopje e tij dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Enkelejd Alibeaj